

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

85H-1  
M 41

VOJSAVA  
NELO

*E qeshur*

*poezi*

SHH-1  
241

Vojsava  
Nelo



E QESHUR

poezi

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## *Pranverën derdhmani në gjoks*

Ju sjell ndër mend, nxënësit e mi,  
ju nxënësit e fshatit malor,  
ju sjell ndër mend me mall e dashuri,  
shpeshherë, o fëmijë ju kujtoj.

Si tufëz me lule në këngën time.  
do mbeteni çelur përjetësisht,  
çdo pranverë do të përtërihet  
prej mallit e prej dashurisë.

Ju sjell ndër mend, o nxënësit e mi,  
oborrin mbushur plot dhe përplot.  
Mbushmani zemrën time, o fëmijë!...  
Derdhmani pranverën në gjoks!...

## *Pranvera e syve*

U zbardh qyteti krejt.  
Corovoda jonë nuse,  
një vogëlushe vjen në bibliotekë  
me fluturza bore mbi supe.

Kërkon një libër, kërkon një yllkë  
sytë i ndrijnë si diell.  
Peizazhi dimëror shtrihet jashtë,  
brenda,  
pranvera e syve.

## Kemi Partinë

Më parë erdhi te ne Partia  
se sa nëna te bija.  
U tundën malet, toka,  
shqipet qenkan më të forta!

Më të fortë se tërmeti,  
më të fortë se stuhia,  
kur Partia shkon mes njerëzve,  
më shpejt se nëna te bija.

## *Si vajzë e dashuruar*

Kam ardhur shpesh te ty Rivierë,  
dhe prapë do të vijë, si vala në breg vjen.

Në çdo ardhje më fal ti motive,  
dhe çaste mbushur me blerime.

Mbushur me aromën e portokallit,  
që të deh tek ecën krah djalit.

~~Si dega e bëshme që nesër lëshon fryshtet,~~  
prej tyre e shëndetshme kënga do të rritet.

Këngë e lirë në brigjet e kaltra,  
ku vjen e bëhet copë e thërrime dallga,

ku lindin mëngjeset nën degëzat e blerta  
ngadalë si të rrinë të fshehta.

Një mbrëmje, Rivierë, me ty bashkë,  
kaq pak fjalë futur në varg.

Nuk munda, nuk munda të shkruaja më gjatë,  
si vajza e dashuruar që djalit i thotë pak.

## *Mes nesh komisar*

Nga malet tonas morëm një gur  
skalitëm portretin tënd,  
komisar!

Fytyrë e gjallë,  
buza gjysmë e hapur nga fjalë e pathënë,  
sytë zjarr.

Mbi gur i heshtur, i skalitur  
shoku komisar,  
ish kohë betejash, kohë lufte,  
dhe yjesë përmby ballë.

Mbi gur i heshtur i skalitur...

Ne vrashim mendjen dita - ditës  
për grurin që piqet në arë,  
për shqetësimet që vërtiten globit,  
për barkun e zezakut nga bajoneta çarë,

ne vrasim mendjen, komisar!

Ty s'të rrihet,  
heshtjen brenda gurit breñ  
zemra jote — zjarr.

Mes nesh epik è madhështor,  
shoku komisar!

## *Agu i mëngjesit e gjeti zgjuar*

Nuk e zinte gjumi atë natë,  
qe bërë dasma e birit të saj.  
Ajo dhe yjet qenë zgjuar akoma,  
të tjerët të gjithë të flenë ranë.

Zbardhi dita e në jatakun e qiellit  
edhé yjet ranë në qetësi,  
vetëm ajo nuk u mbështet fare,  
vetëm ajo nuk mbylli sy.

Të gjitha i vuri në vend me merak  
enët, këpucët në prag të shtëpisë,  
pastaj u nis për ujë në krua,  
në maj të gishtave u nis.